

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®

### PRAJMER DHE MBROJTJE KUNDËR KORRODIMIT TË ARMATURËS



#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® është llaç çimentoje me 3 përbërës i modifikuar me rrëshirë epokside dhe inhibitor korrodimi, që përdoret si prajmer dhe mbrojtje kundër korrodimit të armaturës. SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® plotëson kërkesat e EN 1504-7.

#### PËRDORIMET

- I përshtatshëm për kontroll të zonave anodike (Parimi 11, metoda 11.1 EN 1504-9)
- I përshtatshëm për meremetimin e betonit si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës.
- I përshtatshëm si prajmer mbi beton dhe llaç

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përmban teknologjinë EpoCem® - agjent i përmirësuar për ngjitje
- Kohë të zgjatura punë për llaçet e meremetimeve
- Kompatibël me shumicën e llaçeve për meremetime Sika MonoTop®
- Ndërkapje e shkëlqyer mbi beton dhe çelik
- Përmban inhibitor korrodimi
- I certifikuar për aplikim në kushte ngarkese dinamike
- Rezistencë e mirë ndaj depërtimit të ujit dhe klorureve
- Rezistencë e lartë ndaj shkarjes
- Kohë e gjatë punueshmërie
- Përzierje e lehtë
- Mund të aplikohet me furçë ose pistoletë spërkatjeje

#### MIRATIME / STANDARDE

- Mbart markën CE dhe Deklaratën e Performancës si llaç për mbrojtje kundër korrodimit të armaturës së betonit sipas EN 1504-7: 2006, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë, e lëshuar nga organi i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe testimit të llojit.
- BAM Instituti Federal për kërkimin dhe testimin e materialeve, Berlin, Gjermani, Raport testimi i llojit fillestar sipas EN 1504-7, Nr. BAM VI.1 / 14574-2 datë 13/05/2009
- BAM, Instituti Federal për kërkimin dhe testimin e materialeve, Berlin, Gjermani - Aplikim nën ngarkesë dinamike - Nr. VII.1/126904/1, datë 01/07/2008
- Instituti i Polimereve, Flörsheim-Wicker, GJERMANI - Përcaktimi i dështimit në shkarje ndërmjet betonit të vjetër dhe të ri, Nr. P 2965, datë 30/09/2002.

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento Portland, rrëshirë epokside, agregate të përzgjedhura dhe aditivë
Ambalazhi	20 kg: A (1.14 kg) + B (2.86 kg) + C (16 kg)

Paraqitja / Ngjyra	Përbërësit e përzierë: gri e errët	
	Përbërësi A	lëng i bardhë
	Përbërësi B	lëng pa ngjyrë
	Përbërësi C	pluhur gri i errët
Jetëgjatësia	12 muaj	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe të freskëta midis +5 °C dhe +25 °C.	
Dendësia	A+B+C: ~2.0 kg/l në 23 °C	

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 1.5 N/mm <sup>2</sup> (MPa) (pas 28 ditësh)	(EN 1542)
Ndërkapja në prerje	Kalon	(EN 15184)
Koeficienti i zgjerimit termik	~18 x 10 <sup>-6</sup> 1/K	(EN 1770)
Rezistenca ndaj difuzionit të avujve të ujit	μH <sub>2</sub> O ~500	
Rezistenca ndaj difuzionit të dioksidit të karbonit	μCO <sub>2</sub> ~7300	
Prova e korrodimit	Kalon	(EN 15183)

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	<p>SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® është pjesë e sistemit Sika® për meremetime dhe pëmbush pjesën përkatëse të Standardit Europian EN 1504 dhe përbëhet nga:</p> <p><b>Mbrojtje kundër korrodimit të armaturës / prajmer:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® për kërkesa të larta</li> </ul> <p><b>Llaçe për riparime:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sika® MonoTop®: Seri llaçesh me performancë të lartë dhe bazë çimentoje</li> <li>▪ SikaRep®: Seri bazë me llaçe për riparime me bazë çimentoje</li> </ul> <p><b>Llaç për izolimin e mikroporozitetit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sikagard®-720 EpoCem® për kërkesa të larta</li> </ul>
----------------------	--

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	<p>Si mbrojtje kundër korrodimit: ~ 2 kg për m<sup>2</sup> dhe shtresë aplikimi (trashësi ~1 mm) Të paktën në 2 shtresa (trashësi ~2 mm)</p> <p>Si prajmer: &gt; 1.5 deri 2.0 kg për m<sup>2</sup> /mm në varësi të kushteve të nënshtresës</p>										
Temperatura e mjedisit	+5 °C minimum; +30 °C maximum										
Temperatura e nënshtresës	+5 °C minimum; +30 °C maximum										
Koha e punueshmërisë	~ 3 orë (në +20 °C)										
Koha e pritjes / mbiveshja	<p>Koha maksimale e pritjes përpara aplikimit të llaçit për meremetim Llaçet për meremetime Sika dhe betoni me mpiksje jo të shpejtë mund të aplikohen mbi SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® me kohë maksimale:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Temperatura</th> <th>Koha max. e pritjes</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>+5 °C</td> <td>6 orë</td> </tr> <tr> <td>+10 °C</td> <td>5 orë</td> </tr> <tr> <td>+20 °C</td> <td>2 orë</td> </tr> <tr> <td>+30 °C</td> <td>1 orë</td> </tr> </tbody> </table>	Temperatura	Koha max. e pritjes	+5 °C	6 orë	+10 °C	5 orë	+20 °C	2 orë	+30 °C	1 orë
Temperatura	Koha max. e pritjes										
+5 °C	6 orë										
+10 °C	5 orë										
+20 °C	2 orë										
+30 °C	1 orë										

# UDHËZIME APLIKIMI

## CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

### Betoni:

Betoni nuk duhet të ketë pluhur, material të lirë, kontaminime sipërfaqësore dhe materiale të cilat reduktojnë ngjitjen ose parandalojnë përthithjen apo lagjen nga materialet e riparimit. Betoni i shpëtëzuar, i dobët dhe i shkatërruar dhe kudo që nevojitet edhe betoni i qëndrueshëm duhet të hiqen me mjetet e përshtatshme.

Sipërfaqja duhet të laget e gjitha paraprakisht dhe nuk duhet të thahet përpara aplikimit të llaçit për meremetimin e betonit. Sipërfaqja duhet të arrijë një paraqitje mat të errët pa shkëlqim dhe porët apo gropat e sipërfaqes nuk duhet të përmbajnë ujë.

### Armatura prej çeliku:

Ndryshku, produkte korrodimi (smërç, etj.), llaçi, betoni, pluhuri dhe materiale të lira të tjera të dëmshme të cilat reduktojnë lidhjen ose kontribuojnë në korrodimin duhet të hiqen dhe të bëhet pastrimi i armaturës deri në SA 2 sipas ISO 8501-1. Sipërfaqet duhet të përgatiten me teknika pastrimi me fryrje abrazive ose curril uji në presion të lartë.

## PËRZIERJA

SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® mund të përzihet me mikser elektrik me shpejtësi të ngadaltë (<250 rpm).

Tundni përbërësit A dhe B plotësisht përpara hapjes. Hidhni përbërësit e lëngshëm A+B brenda një enë të përshtatshme për përzierje dhe përzieni për 30 sekonda. Ndërsa jeni ende duke përzierë përbërësit A+B, shtoni ngadalë pluhurin e përbërësit C. Përzieni këta tre përbërës së bashku të paktën për 3 minuta, duke minimizuar shtimin e ajrit. Lëreni të qëndrojnë për 5 – 10 minuta deri sa materiali i përzierë të paraqesë një konsistencë që mundëson aplikimin me furçë, por që nuk është e rrjedhshme.

MOS SHTONI UJË!

## APLIKIMI

Si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës:

Aplikoni shtresën e 1-rë me trashësi ~ 1.0 mm, duke përdorur një furçë me fortësi mesatare ose pistoletë spërkatjeje mbi armaturën e pastruar. Aplikoni shtresën e 2-të, kur shtresa e parë është e fortë në prekje me thoin e gishtit (~2 - 3 orë në +20°C). Aplikoni shtresat vijuese të llaçit të njomë mbi të thatë (në këtë mënyrë nuk fshihet shtresa mbrojtëse).

Si prajmer:

Aplikoni duke përdorur një furçë me trashësi mesatare ose pistoletë spërkatjeje mbi nënshtresën e përgatitur. Për të arritur një ngjitje të mirë, SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® duhet të aplikohet mirë mbi nënshtresë, duke mbushur të gjitha porët (trashësi min. shtrese 0.5 mm). Aplikoni shtresat vijuese të llaçit të njomë mbi të njomë. SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® i freskët duhet të mbrohet nga kontaminimi dhe shiu derisa të aplikohet llaçi i riparimeve.

Aplikim nën ngarkesë dinamike:

SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® është testuar me llaçet riparues të mëposhtëm Sika dhe është certifikuar për aplikime nën ngarkesa dinamike. Për informacion të mëtejshëm referohuni në skemat teknike përkatëse.

Procesi i spërkatjes së thatë:

Mbrojtja kundër korrodimit:	SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®
Riparim dhe mbiveshje:	SikaCem®-Gunitite 133

Procesi i spërkatjes së lagësht:

Mbrojtja kundër korrodimit dhe/ose prajmer:	SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®
Riparim dhe mbiveshje:	Sika MonoTop® Dynamic HP, seria Sika MonoTop®-412

## METODA E MATURIMIT

Llaçi i freskët duhet të mbrohet nga shiu ndërsa materiali nuk është mpiksuar ende.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

- Referohuni tek "Method Statement për meremetimin e betonit" me sistemin Sika MonoTop® për më tepër informacione rreth përgatitjes së nënshtresës ose referohuni tek rekomandimet e dhëna tek EN 1504-10
- Shmangni aplikimin në diell të drejtpëdrejtë dhe/ose shi.
- Mos shtoni ujë.
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresat e qëndrueshme dhe të përgatitura.
- NUK rekomandohet për përdorim me llaç apo beton që mpikset shpejtë p.sh. Sika MonoTop®-211 FG / RFG

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®  
Prill 2019, Botimi 03.01  
020302020050000001

SikaTopArmatec-110EpoCem-sq-AL-(04-2019)-3-1.pdf